

Sonja Sarbach, Prof.
Docente për Didaktikë

Buchenstrasse 2
CH – 9524 Zuzwil
+41 (0)71 944 22 04
+41 (0)79 485 85 66
sonja.sarbach@phsg.ch


RAPORTI I EKSPERTIT

(Versioni Final)

Edukimi i qëndrueshëm parashkollor dhe paqe Programi Dielli

25 maj 2010

Hyrje:

Raporti vetë-vlerësues është gjithëpërfshirës, i strukturuar mirë dhe i lehtë për t'u lexuar. Është përpiluar me kujdes dhe është informativ sa i përket përmbajtjes si dhe i ilustruar me shembuj shpjegues dhe shqyrtime. Në veçanti, përshkruarit e moduleve të cilët janë prezantuar janë të detajuar dhe gjithnjë të shoqëruar me shpjegim sa i përket rezultateve të mësimit si dhe përmbajtjes që mundëson një pamje të qartë të asaj  ofrohet për t'u mësuar.

Në fazën e parë të projektit ky RVV jep një prezantim të qartë të programit akademik, që ishte një ndihmesë e madhe për ekspertin gjatë përgatitjes së saj për vizitë në terren.



Vizita në terren shkoi mirë dhe ishte e mirëorganizuar nga institucioni. Eksperti ishte i mirëpritur nga të gjithë të përfshirët dhe atmosfera ishte e relaksuar si dhe transparente. Pyetjet u përgjigjën, shqetësimet u adresuan dhe u përmenden edhe kritikave si dhe u komentuan ato. Në fazën e parë instituti tashmë kishte shfaqur vullnetin dhe ishte i përgatitur për të punuar me institucionet tjera dhe me autoritetet, si dhe ishte i përgatitur të zbatonte ndryshimet e nevojshme. Kjo qasje e hapur ishte shumë e qartë gjatë vizitës në terren.

1. Qëndrimi i Misionit


Edukimi i qëndrueshëm parashkollor dhe paqe, programi Dielli është një program i Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës. Për këtë arsye, qëndrimi i misionit i tanishëm i Universitetit të Prishtinës, si dhe i Fakultetit të Edukimit paraqet një qëndrim misioni edhe për Programin Dielli.

Më tej, programi akademik ka marrë si model orientues faktorët kërkimorë që kanë të bëjnë me arsimimin e fëmijëve 4-6 vjeçarë. Mësuesit parashkollorë kanë rolin e një shoqëruesi edukativ i cili rregullon dhomën dhe materialin për zhvillimin individual të fëmijëve. Loja (e lirë dhe e orientuar) është instrumenti kryesor i mësuesit parashkollor. Muzika, artet, nxitjet dhe kultura janë poashtu domene të

rëndësishme edukative. Bashkëpunimi me prindër është fundamental. Përmbledhja e synimeve, vlerave dhe planit të përgjithshëm të Programit Dielli është bindëse dhe qëndrimi i misionit është i strukturuar mirë dhe përmban aspektet kryesore. Është evident potenciali për inovim. Ky është një institucion i ri dhe modern, i cili është themeluar sipas Bolonjës dhe i ndërtuar nga ekspertë pedagogjikë prej gjithë botës mbarë, që kanë kontakt me universitete dhe qendra kërkimore nga vende të ndryshme.

Institucionet partnere siç janë Caritasi Zvicër, Caritasi Luksemburg,  ST Kosovë, Departamenti për  ukim Drenas dhe IPF që të gjithë janë dëshmitarë të këtij bashkëpunimi akademik dhe poashtu sigurojnë që prezenca e institutit të jetë e dukshme jashtë Kosovës.

Rekomandimi i Ekspertit:

Instituti ka nevojë të ketë webfaqen e vet (si pjesë e Fakultetit të Edukimit, Prishtinë) nëse mëton të përmirësojë prezencën e vet ndërkombëtare dhe të jetë i dukshëm për botën akademike. Kjo webfaqe do të mund të përfshinte:  caktorët e kursit të edukimit, publikimet e institutit, programet verore, vendet e lira të punës, etj.

2. Liria Akademike

Institucioni duket se garanton lirinë në punë kërkimore dhe mësimdhënie nga mënyra si është organizuar dhe është përpiluar në organogram.

3. Programet akademike dhe menaxhimi i studentëve

Programet akademike i korrespondojnë qëndrimit të misionit të institucionit. Programi është i bazuar në konceptin didaktik të arritjes që është komunikuar në mënyrë adekuate dhe i cili gëzon mbështetjen ndërkombëtare.

Sipas literaturës së përmendur dhe disa gjetjeve të hulumtimeve që kanë të bëjnë me edukimin e nxënësve të moshës parashkollore, është e nevojshme që të zhvillohet perceptimi dhe shkathësitë motorike, njohëse, shoqërore dhe ato

emocionale në katër deri gjashtëvjeçarët nëse dëshirohet që të vëhet themeli për aftësitë dhe arritjet e mëvonshme shkollore. Programi Dielli përçon këtë dhe zbaton parimet përmes mjeteve të lojës, artit, muzikës dhe lëvizjeve. Programi i trajnimit ka si parim kryesor nevojën për lojë si një formë primare efektive e mësimit në nivelin parashkollor dhe kjo është qartazi e dukshme në institucionet parashkollore që i përkasin programit.

Të gjitha institucionet parashkollore ku studentët absolvojnë trajnimin e tyre janë të pajisura me lojëra dhe materiale tjera të mësimit të hershëm që ofrojnë një mbështetje optimale për zhvillimin edukativ të fëmijëve parashkollorë përmes lojërave në fusha dhe staza të ndryshme.

Trajnimi i mësimdhënësve nuk bëhet në formë ligjëratash por në formë të seminareve, në grupe tutoriale. Programi trajnues vë theks të veçantë në mësimin përmes të bërit, nuk pret nga studentët që thjeshtë të dëgjojnë ligjëratat në temat e mësimit, por pret nga ta dhe i inkurajon që të eksperimentojnë dhe të provojnë përvojën e klasës. Si rezultat, kjo qasje e bën teorinë si forcë shtytëse për praktikën dhe e bën atë më të memorueshme dhe më të lehtë për t'iu qasur. Megjithatë, duhet shtuar se duhet kujdesur që të mbështetet inputi i nevojshëm teorik në lëndë siç janë leximi dhe puna me numra, zhvillimi mental dhe teoritë e mësimit, modelet e mësimit, etj, përmes ofrimit të dokumenteve të shkruara dhe librave si dhe përmes dheniës së kohës së nevojshme për t'i lexuar dhe mësuar ato. Ky ishte një kritikizëm konstruktiv, i sugjeruar poashtu nga studentët.

Tipari më i veçantë i këtij programi trajnues për mësues është fakti se është një program në-shërbim, përmes të cilit studentët vijnë nga shkollat e përzgjedhura enkas për program, mësimi i mësimdhënësve bëhet gjatë sesioneve të veçanta javore dhe blloqeve prej një jave ose më shumë. Së bashku me të ka edhe vazhdime të ndryshme kursi në atë mënyrë që njohuria ekzistuese dhe kualifikimet e studentëve të mund të merren parasysh. Për shembull, dikush që tashmë ka marrë diplomë universitare, do të ketë module të ndryshme që do t'i akreditohen atij.

Kjo formë e arsimit të mësuesve është përshtatur për gjendjen politike, sociale, ekonomike, kulturore dhe historike në të cilën është Kosova. Më tej, është shumë e nevojshme që programi parashkollor i cili do të bëhet i detyrueshëm vitin e ardhshëm të vëhet në praktikë dhe të krahasohet me standardet dhe trendet ndërkombëtare. Kjo vlen sidomos për mësimdhënëset femra që vijnë nga zonat rurale (mungesa e transportit publik, përgjegjësitë familiare etj) prej minoriteteve dhe/ose prej rrethanave të vështira, të cilët kanë nevojë për mbështetje shtesë nëse mëtojnë t'i arrijnë standardet dhe aftësinë profesionale evropiane.

Fakti që ligjeratat bëhen të shtunave nënkupton se ajo çfarë është mësuar në teori do të mund të provohej në praktikë të hënen e ardhshme dhe studentët mund të punojnë së bashku në mënyrë që të studiojnë përvojat mësimdhënëse dhe janë në gjendje t'i ndihmojnë njëri-tjetrit në mënyrë që të reflektojnë në praktikën e tyre të mësimdhënies.

Metodologjia e programit është pasuruar nga detyra individuale të studimit dhe detyrave në grup në të cilat një temë e veçantë është hulumtuar dhe më pastaj e prezantuar në grup në sekuenca të shkurtëra mësimdhënieje. Detyrat si këto kërkojnë kohë nga pjesëmarrësit që të zhvillojnë shkathtësitë e tyre socio-komunikative dhe të bashkëpunimit dhe aftësinë e tyre që të përpilojnë argumente me lidhje logjike. Shkathtësitë tjera që inkurajohen janë fleksibiliteti, mundësia për të reflektuar dhe promovimi i vetëdijës.

Nga vizita e shkollave të kyçura në program ishte e lehtë të observej se si është zhvilluar ky program, që i krahasuar me standardet Kosovare është një standard më i lartë i mësimdhënies në nivelin e synuar dhe është në një nivel standardi modern i orientuar nga perceptimi i mësimdhënies së mirë.

Një pjesë tjetër e rëndësishme e kësaj skeme të edukimit të mësimdhënësve është edukimi në lidhje me pedagogjinë e paqes, që paraqet një pjesë të rëndësishme të kurikulës së edukimit në një vend me diversitet të madh etnik që është duke kaluar përmes një përvoje të pas luftës. Kjo situatë e veçantë historike është marrë plotësisht në konsideratë në politikat edukative dhe programet e edukimit të paqes nuk janë që vetëm flitet për to, por janë të jetuara dhe të aplikuara në praktikë. Kjo

është aq më shumë e vërtetë në një program multietnik parashkollor që edhe e ka nxitur shfaqjen e programit dhe i cili është ilustrativ sa i përket praktikave më të mira si model shembull për shkollat tjera.

Vetë studentët çmojnë këtë program arsimor të mësimdhënësve dhe thonë se janë shumë të kënaqur me përmbajtjen e kursit dhe me trajnerët e tyre. Ia vlen të përmendet se kjo kënaqësi ndjehet nga studentët që tashmë kanë absolvuar në një trajnim më të mëhershëm në Fakultetin e Edukimit. Trajnerët çmojnë shumë qasjen praktike dhe lidhjen e qartë me praktikën në klasë, poashtu metodat e teknologjitë e ndryshme dhe moderne që ofrohen, së bashku me përmbajtjen e qartë dhe të përditësuar si dhe me infrastrukturën përcjellëse.

E gjithë kjo ka shpjerë në zbatimin e suksesshëm të synimeve të caktuara nga programi dhe te rezultatet e suksesshme profesionale në të gjitha nivelet që kanë të bëjnë me kompetencën e kualifikimit dhe me aftësitë.

Ngarkesa e programit akademik është e përballueshme nga studentët. Diploma akademike që jepet korrespondon me standardet ndërkombëtare dhe me caktimin e kredive ECTS që janë adekuate dhe të kuptueshme. Shkalla në mes personelit akademi/artistik ndaj atij të studentëve është e përshtatshme. Rregullat e provimeve (ekzaminimeve) janë adekuate dhe transparente.

Rekomandimi i Ekspertit:

Do të duhej kushtuar kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për mësimdhënien përkatëse të teorisë së mësimin dhe modeleve pedagogjike metodologjike, ndoshta edhe përmes moduleve të përpiluara në mënyrë të veçantë, për shembull si një modul i studimit të thelluar në vitin e dytë dhe të tretë të programit të trajnimit ose si pjesë obligative e akademisë verore. Libra të dobishëm për këto module ose sesione trajnimi do të mund të ishin: Zhvillimi dhe Mësimi (Vygotsky), Loja dhe mbështetja e mësimin në kopshte të fëmijëve (Johnson, Christie dhe Yawkey, 1987; Bodrova und Leong, 2008; Collins, Brown dhe Newman 1989, Textor/Vygotsky, 2000). Menaxhimi i klasëve (Everton, Emmer, Worsham, 2003), Tiparet në mësimdhënien cilësore parashkollore (Hauser 2007, EEPE-Studie).

Tema tjera do të mund të ishin: leximi, numrimi, zhvillimi i gjuhës, programet mbështetëse edukative të orientuara drejt synimeve.

Per disa nga këto tema do të ishte e këshillueshme një sinergji në mes të fakultetit të edukimit të Universitetit të Prishtinës dhe universiteteve tjera.

- Dhënia studentëve një dosje me libra si pjesë qendore e modulit të teorisë akademike (shih më lartë) do të mund të ishte poashtu e këshillueshme dhe ndoshta do t'ia vlente të përcillej megjithë se sigurisht kjo do të nënkuptonte punë shtesë, pasi që një numër i rëndësishëm i artikujve me vlerë do të duhej të përktheheshin në anglisht ose në shqip. Sigurisht se një dosje e tillë do të mund të zhvillohej gjatë periodave të semestrave dhe një skriptë e këtij lloji do të mund t'i jepte një peshë profesionale gjithë kursit dhe do t'i jepte transparencë përmbajtjes së tij. Një avantazh i shtuar do të ishte se këto dokumente të shkruara do të mund të përdreshin si element kryesor për ekzaminatorët.

4. Puna kërkimore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Studentët janë të përfshirë në punë kërkimore. Kjo ndodh në shkollat ku janë të përfshirë studentët ose përmes disertimeve në diplomën Bachelor dhe diploma tjera.

Programi përfshin një metodologji vlerësuese që ndihmon në ndërlidhjen e praktikës me teorinë dhe shpie drejt reflektimit sa i përket saj.

Personeli i cili ka përpiluar programin për arsimim të mësimdhënësve e ka bërë këtë përmes studimit dhe duke iu referuar literaturës së shkruar në lidhje me studimet e bëra në pedagogjinë parashkollore dhe duke i përdorur këto të dhëna për modelin e tyre. Për këtë arsye, mund të thuhet se Programi Dielli është si rezultat i literaturës dhe praktikës kërkimore të aplikuar sa i përket bazës kontekstuale dhe është i përditësuar si program i arsimimit të mësimdhënësve parashkollorë që është.

Programi është vlerësuar disa herë me kujdes, poashtu nga ana e donatorëve dhe ndikimi i tij në shkollat në të cilat aplikohet është analizuar dhe më pastaj programi është përmirësuar si rezultat i gjetjeve.

Anëtarët e programit kanë bërë punë kërkimore sa i përket nevojave të 4 deri 6 vjeçarëve në Kosovë dhe kanë publikuar një raport në lidhje me këtë. Tutorët e programit janë në kontakt të përhershëm me profesionistët nga universitetet tjera (Zvicër, Luksemburg, Angli, Gjermani, etj) dhe poashtu marrin pjesë në konferenca.

Do të ishte i mundur edhe një program për shkëmbim të studentëve me një universitet tjetër. Shkalla dhe cilësia e bashkëpunimit ndërkombëtar është e mirë.

Rekomandimi i ekspertit:

- Duhet të mbështetet puna kërkimore që është në vazhdim. Bashkëpunimi në punë kërkimore me Fakultetin e Edukimit të UP duhet të forcohet.
- Njëkohësisht, duhet të hulumtohet në lidhje me mundësinë e pjesëmarrjes në projekte kërkimore që janë duke u bërë në BE dhe në universitetet tjera të edukimit të mësimdhënësve;
- Do të duhej mundësuar pjesëmarrja e tutorëve në konferencat ndërkombëtare në të cilat prezantohen hulumtimet e fundit në mësimin e fëmijëve parashkollorë 4-6 vjeçarë dhe në “fëmijërinë e hershme”.

5. Personeli

Arsimimi i mirë i mësimdhënësve kërkon tutorë të mirë të cilët kanë përvojë didaktike e metodologjike në mësimdhënien e lëndës/nivelit të cilin e ofrojnë. Kjo përvojë është garancion për ndërlidhjen e teorisë me praktikën. Sa i përket mësuesve parashkollorë, ata duhet të jenë të gjithanshëm pasi që mësimi i 4-6 vjeçarëve kërkon një qasje të përgjithshme dhe jo të specializuar vetëm në një fushë, është kjo qasje e përgjithshme dhe kjo përvojë të cilën duhet ta kuptojë

tutori. Një qasje e specializuar në një lëndë do të ishte në kundërthënie me gjithëçka që është e njohur për zhvillimin e parashkollorëve.

Në këtë pikë sistemi i trajnimit dhe arsimimit të mësuesve që është i zakonshëm, dallon shumë nga trendi i përbashkët në Evropë dhe në universitete tjera. Një diplomë mësimdhënie në Kosovë rezulton në një diplomë në një fushë të specializuar dhe jo në edukim të përgjithshëm. Për këtë arsye, kriteret për punë kërkimore dhe për personel nuk mund të peshohen njëjtë.

Është e vërtetë se derisa u bë traktati i Bolonjës, nuk ishte e mundur që të studiohej në nivel universitar për t'u bërë mësues parashkollor. Si rezultat i kësaj, nuk ka tutorë/ligjërues në arsimimin parashkollorë që kanë doktoratë, kështu që ky kriter nuk mund të vlerësohet ose të merret në konsideratë në mënyrë se si është në fakultetet tjera. Cilësia e tutorëve në nivelin parashkollor qëndron në pasurinë e përvojës së tyre praktike dhe profesionale si dhe njohurive, në vullnetin e tyre angazhohen në shkëmbime me profesionistët tjerë dhe përmes studimit të revistave dhe punës kërkimore profesionale.

Institucioni ka një pjesëmarrje adekuate të femrave në personelin akademik. Tutorët kryesorë në Programin Dielli janë siguruar që të krijojnë personel që ka kualifikimin e nevojshëm. Personat përgjegjës për ofrimin e programit janë siguruar që kanë bërë personel (duke përfshirë mësuesit vendorë) që është kompetent dhe i kualifikuar. Kualifikimet e mëtejme janë të mundshme dhe janë të planifikuara trajnime të anëtarëve të personelit.

Ligjërues nga shtetet tjera evropiane do të ftohen për periudha të kufizuara kohore. Është planifikuar një sinergji me Fakultetin e Edukimit të UP kështu që ligjëruesit që kanë doktorata të tyre do të mund t'i japin studentëve pjesëmarrës në program benefitin e njohurive të tyre.


Rekomandimi i Ekspertit:

- Do të ishte e dëshirueshme që në të ardhmen një ligjërues me nivelin master të jetë gjithnjë prezent në program në mënyrë që të garantojë

vijueshmërinë dhe të shtojë reputacionin e programit dhe validitetin e tij akademik.


- Sinergjia e planifikuar me Fakultetin e Edukimit, d.m.th. shkëmbimi i ligjëruesve (historia e edukimit të paqes prej programit Dielli dhe Historia e Filozofisë së Edukimit prej Fakultetit të Edukimit) do të duhej të bëheshin fakt.
- Postet vakante do të duhej publikuar dhe do të duhej të punësoheshin profesorë të jashtëm nga universitetet tjera evropiane, kjo përsëri në mënyrë që t'i shtohet vlerë akademike programit.

6. Organizimi, Menaxhimi dhe Planifikimi

Strukturat vendimmarrëse dhe ato të përpilimit të politikave janë transparente. Institucioni ka një Këshill ekspertësh me funksion këshillimor që është kompetent, si pjesë e këtij këshilli janë përfaqësuesit e departamentit të edukimit dhe autoritetet e edukimit. Programi është zhvilluar në bashkëpunim me  ST dhe është një projekt i Caritas-it Zvicerian. Një zgjerim i programit në mënyrë që t'i përfshijë 80-100 mësimdhënës, 20 praktikantë dhe 200 fëmijë të kopshteve është planifikuar të ndodhë në vitin 2011.

Caritas-i ka planifikuar një vlerësim të jashtëm për në fund të fazës pilot, d.m.th për 2011.

Në fillim të 2012 do të duhej të ngrihej një organ për menaxhimin e cilësisë për qendren kërkimore dhe të trajnimit për edukim parashkollor dhe do të duhej të ketë përfunduar vlerësimi i fazës pilot.

Më tej, hapat e mëtejme në implementimin e programit në Universitetin e Prishtinës janë: nënshkrimi i kontratave në mes udhëheqësit dhe Senatit, një punëtori për përpilimin e moduleve akademike, diskutimet në lidhje me buxhetin në mes të zyrës së udhëheqësit dhe  ST.

Institucioni duket të jetë inovativ dhe i hapur ndaj ideve të reja.

Rekomandimi i Ekspertit:

- Në zbatimin e programit nga Universiteti i Prishtinës do të duhej që cilësia dhe profili i programit Dielli të mbeteshin të paprekura dhe që Universiteti i Prishtinës të njohë programin Dielli dhe që qëndrimi i misionit të jenë të bazuar në metodologji moderne parashkollore dhe është kjo metodologji dhe pedagogjia moderne që i japin programit profilin e tij, kjo pra do të duhej të ishte brenga kryesore për të ardhmen.
- Kur të jetë zbatuar programi i Universitetit të Prishtinës atëherë do të duhej rishikuar vazhdimi i këtij organizimi dhe kontrolli i cilësisë.

7. Financat dhe Infrastruktura/Hapësira dhe Pajisjet

Financat:

Plani financiar është i detajuar dhe tregon se ka burime financiare të mjaftueshme. Që nga viti 2002 e deri në 2011, Caritasi dhe të tjerët kanë organizuar dhe financuar programin në partneritet dhe do të vazhdojnë të bëjnë këtë. Synimi i tanishëm prej Caritas-it është të integrojë programin me Fakultetin e Edukimit UP në vitin e ardhshëm akademik. Ky plan tregon qartësisht shpenzimet për integrimin e programit në programet e UP.

Qendra Dielli ka qenë dhe mbetet pronë e komunës së Drenasit dhe është ofruar nga komuna për qëllime trajnimi dhe arsimimi për një periudhë prej 99 vjetësh. Në mbajtjen e marrëveshjes me Caritas-in, komuna është e ngarkuar për ta mbajtur atë.

Infrastruktura:

Ndërtesa e sapo rinovuar e Diellit në Drenas përfshin jo vetëm pesë klasët që jashtë orarit shkollor do të mund të shfrytëzoheshin për qëllime trajnimi, por poashtu një zyrë, një dhomë për personelin dhe një dhomë për mësimdhënie. Biblioteka është në dhomën për mësimdhënie siç janë edhe tre kompjuterë që kanë qasje në internet, këta kompjuterë janë gjithnjë në dispozicion të trajnerëve. Të gjitha dhomat janë të ndriçuara dhe të ajrosura, të pastërta dhe të pajisura në mënyrë funksionale.

Hapësira e jashtme e rrethuar e cila është dizajnuar sipas gjetjeve të fundit pedagogjike, i ofron studentëve dhe fëmijëve parashkollorë një atmosferë që është nxitëse ndaj mësimimit dhe relaksimit.

Biblioteka është ende në fillimin e saj, por publikimet janë në dispozicion dhe janë të reja si dhe relevante. Fatkeqësisht sa i përket edukimit parashkollor dhe metodologjisë nuk ka publikime në shqip, për këtë arsye programi duhet të bazohet në publikimet gjermane. Është një fakt fatkeq që sa i përket metodologjisë parashkollore ka shumë pak literaturë edhe në nivelin ndërkombëtar pasi që ky është një nivel që vetëm tani ka filluar të shihet si i rëndësishëm nga aspekti akademik. Për këtë arsye, publikimet në këtë lëmi vetëm tani kanë filluar të dalin në bazë të rregullt (EPPE-Studie).

Qasja në bibliotekë, publikime akademike dhe literaturë përmes internetit e bën shfrytëzimin e studimeve të publikuara akademike dhe punimeve ndërkombëtare një punë të lehtë dhe më relevante si dhe më motivuese. Si rezultat, kjo formë studimi ka filluar të jetë më e zakonshme se sa e jashtëzakonshme për nxënësit. Poashtu kjo formë e qasjes në libra virtuale e shndërron punën kërkimore dhe bibliotekën klasike me huazim të librave më pak të nevojshme se sa ka qenë.

Më tej, Universiteti i Prishtinës është i vullnetit të hapë derën e bibliotekës së vet për pjesëmarrësit e programit, gjë që është me shumë dobi sa i përket shpenzimeve.

Parcela fqinje e tokës është në pronësi të Komunës së Drenasit, kështu që ndërtesat do të mund të zgjeroheshin nëse numri i studentëve do ta kërkonte një gjë të tillë.

Infrastruktura është moderne, nxitëse dhe e përshtatshme për një numër pjesëmarrës kurse. Fakti që klasët janë brenda ndërtesës i mundëson studentëve mundësinë unike që të jenë në gjendje të shohin drejtpërdrejt teorinë të cilën e mësojnë të kombinuar me praktikën.

Rekomandimi i Ekspertit:

- Në vitet që vijnë, do të duhej pasuruar biblioteka me publikime të reja dhe libra që janë drejtpërdrejt relevantë për modulet që jepen në anglisht dhe në shqip (shih rekomandimin 3 të ekspertit). Kjo do të mund të bëhej edhe në mënyrë digjitale.

8. Menaxhimi i Cilësisë

Instituti ka një sistem të shkëlqyeshëm të sigurimit të cilësisë për shërbimet mësimdhënëse, kërkimore dhe shërbimet. Vlerësimet bëhen në bazë të rregullt në mënyrë interne dhe të jashtme dhe rezultatet përfshihen në planet zhvillimore dhe programet përmirësohen gjithnjë.

PËRFUNDIM:

- Institucioni e shfaqti veten të jetë mjaft i hapur ndaj rekomandimeve të ekspertëve që u bënë në raportin preliminar dhe kanë bërë disa sugjerime konkrete e konstruktive për zbatim në të ardhmen.
- Programi edukativ për mësues Dielli është shumë i përshtatshëm që të marrë mbi vete përgjegjësinë dhe të zbatojë një kurs trajnimi për mësimdhënësit e fëmijëve të moshës parashkollore në Kosovë dhe këtë në përputhje me një standard evropian.